



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE  
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA  
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR

VENDIM  
Nr.37, datë 11.07.2019

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË UJËSJELLËS KANALIZIME MALLAKASTËR  
SH.A.

Në mbështetje të nenit 13, 14, 15, 16 dhe 17 të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar (**Ligji nr. 8102**), VKM nr. 958, datë 06.05.2009 "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence" (**VKM nr.958**), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29 datë 08.12.2009 "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", e ndryshuar (**Rregullore e licencimit**),

**Komisioni Kombëtar Rregullator,**

në mbledhjen e datës 11.07.2019 pasi shqyrtoi çështjen me objekt: "Mbi miratimin e projekt vendimit "Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Mallakastër sh.a.",

**Vëren se:**

1. Shoqëria Ujësjellës Kanalizime Mallakastër (**UK Mallakastër**) me shkresën nr.316 prot. datë 10.06.2019 ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (**ERRU**) kërkesën për licencim për shkak të mbarimit të afatit.
2. Komisioni Kombëtar Rregullator (**KKRR**) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit të UK Mallakastër në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM nr. 958 dhe Rregulloren e licencimit.
3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton:
  - a) Shoqëria UK Mallakastër ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura për 16 792 banorë (4198 klientë) të Bashkisë Mallakastër si më poshtë:

- Zona e shërbimit me furnizim me ujë dhe kanalizime nga shoqëria UK Mallakastër

Nr.	Njësitë administrative të Bashkisë Mallakastër	Popullsia e shërbyer
1	Mallakastër	11 628
2	Aranitas	272
6	Greshicë	1 176
7	Hekal	2 376
9	Qendër Dukas	1 340
<b>TOTALI</b>		<b>16 792 banorë</b>

*Shënim:* UK Mallakastër për pjesën tjetër të njërive administrative nuk është pajisur me akt miratim higjieno sanitar.

- b) Drejtuesi teknik i shoqërisë z. Kliton Aliaj zotëron diplomë Bachelor në Inxhinieri Gjeoburime, profili inxhinieri Naftë viti 2012.
4. ERRU në vlerësimin e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Mallakastër, të:
- a) Kërkesave të ligjit nr. 8102 si dhe kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si aftësi tekniko-profesionale, aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjellësve dhe kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në lidhje me cilësinë, efikasitetin, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;
- b) Kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e Konkurrencës” të ndryshuar, (*ligji nr. 9121*) për mos lejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve;
5. ERRU, në bazë të vlerësimit dhe verifikimeve të kërkesës së shoqërisë UK Mallakastër rekomandon:
- Shoqëria UK Mallakastër duhet të aplikojë pranë ERRU për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura;
  - Shoqëria UK Mallakastër duhet të punojë në drejtim të pajisjes së sistemeve të furnizimit me ujë së të gjithë zonës me akt miratim higjieno sanitar.

Për gjithë sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e UK Mallakastër është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

### **VENDOSI:**

1. Licencimin e shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Mallakastër sh.a me NUIS K47605804N në kategoritë:
  - a) Kategorija A - Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik

- b) Kategoria C - Për largimin e ujërave të ndotura
2. Shoqëria Ujësjiellës Kanalizime Mallakastër sh.a autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara me:
- a) Drejtues Ligjor – Erjon Zenelaj  
b) Drejtues Teknik – Kliton Aliaj
3. Zona e shërbimit të shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Mallakastër sh.a është:
- Bashkia Mallakastër: Njësitë Administrative Mallakastër  
Aranitas  
Greshicë  
Hekal  
Qendër Dukas
4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4 vjeçare.
5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Mallakastër sh.a detyrohet të nënshkruajë Kushtet e Licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.
6. Ngarkohet Drejtoria Teknike Ekonomike të njoftojë shoqërinë Ujësjiellës Kanalizime Mallakastër sh.a për marrjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.  
Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

**K R Y E T A R I**

**Ndriçim SHANI**